



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.3, datë 06.10.2022

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES
NR.60/2 PROT., DATË 16.10.2017 MIRATUAR ME VENDIMIN
NR.54, DATË 10.10.2017 “PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË,
SUBJEKTIT “ALBERT HOXHA”**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatave të lejes nr.60/2 prot., datë 16.10.2017 miratuar me vendimin nr.54, datë 10.10.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin si më poshtë:

Vendndodhja e veprës së marrjes (KRGJSH)

Nga: X= 538851.6; Y= 4549632.7; Z= 465 m.m.n.d

Në : X= 534530.3; Y= 4553297.3; Z= 453 m.m.n.d

Vendndodhja e vaskave (KRGJSH)

X= 534518; Y= 4553324; Z= 451 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q=0.015 \text{ m}^3/\text{s}$

2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr.60/2 prot., datë 16.10.2017 miratuar me vendimin nr.54, datë 10.10.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin për “Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për Akuakulturë”.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

